



trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A

BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/169

Datë: 13.11.2024

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 14, të mbajtur më 13.11.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

Për plotësim-ndryshime në Rregulloren mbi Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës të HK-Trainkos Sh.A, Nr. I/130 të datës 29.08.2024 si në vijim:

- I. Në Nenin 14, për pozitën Zyrtar i Kontrollit Teknik të Mjeteve Lëvizëse, shtohet edhe një punë-kryes, duke rritur numrin në gjithsej dy (2) zyrtarë për këtë rol.
- II. Në Nenin 19, për pozitën Zyrtar i Kontabilitetit të Shitjeve/Klientëve, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, fshihet në tërësi pika c), “Të jetë i certifikuar si teknik i kontabilitetit”.
- III. Në Nenin 21, për pozitën Zyrtar i Kontabilitetit të Blerjeve/Furnitorëve, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, fshihet në tërësi pika c), “Të jetë i certifikuar si teknik i kontabilitetit”.
- IV. Në Nenin 24, për pozitën Zyrtar Ligjor, nga tre (3) zyrtarë (punë-kryes), mbesin vetëm dy (2) për këtë pozitë.
- V. Në Nenin 26, për pozitën Zyrtar i Pagave, te kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, në pikën a), pas fjalës ”Të ketë të përfunduara studimet universitare në njërën nga këto fusha: Juridike, Ekonomike apo Administrim Biznesi”, shtohet kualifikimi me togfjalëshin “apo *Administratë Publike*”.
- VI. Në Nenin 28, për pozitën Zyrtar i Arkivit, kushtet, aftësitë dhe njohuritë e kërkuara, në pikën a), riformulohen si në vijim: “Të ketë përfunduar shkollën e mesme, apo studimet universitare në njërën nga këto fusha/drejtme: Administrim Biznesi; Juridik, Ekonomik, Arkivistikë”.

- VII. Në Nenin 62, emërtimi për pozitën “Shef i Njesisë së Tërheqjes së Mjeteve Lëvizëse në Transportin e Udhëtarëve” zëvendësohet me emërtimin “Shef i Njesisë së Tërheqjes së Trenave në Transportin e Udhëtarëve”. Ndryshimet për emërtimin e kësaj pozite zbatohen në tërësi në Rregullore, kudo që është theksuar ky emërtim.
- VIII. Në Nenin 86, për pozitën Dispeçer i Mjeteve Tërheqëse dhe të Tërhequra në Transportin e Mallrave, shtohet edhe një punë-kryes, duke rritur numrin në gjithsej dy (2) dispeçerë për këtë pozitë.
- IX. Në Nenin 79, emërtimi për pozitën “Kryepunëtor i Axhustatorëve në Mirëmbajtjen e Vagonëve” zëvendësohet me emërtimin “Kryepunëtor në Mirëmbajtjen e Vagonëve”. Ndryshimet për emërtimin e kësaj pozite zbatohen në tërësi në Rregullore, kudo që është theksuar ky emërtim.
- X. Në Nenin 89, emërtimi për pozitën “Shef i Njesisë së Tërheqjes së Mjeteve Lëvizëse në Transportin e Mallrave” zëvendësohet me emërtimin “Shef i Njesisë së Tërheqjes së Trenave në Transportin e Mallrave”. Ndryshimet për emërtimin e kësaj pozite zbatohen në tërësi në Rregullore, kudo që është theksuar ky emërtim.

Arsyetim: Bazuar në kërkesën e Menaxhmentit për plotësim-ndryshime të kësaj rregulloreje dhe arsyetimeve se këto ndryshime do të ndikojnë në qartësimin dhe funksionimin më të mirë të punëve dhe proceseve në ndërmarrje, Bordi i Drejtorëve ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi. Përmes këtij vendimi, ndryshimet përfshijnë në disa pozita numrin e punë-kryesve, kufizimet në mbikualifikim për disa pozita dhe ndryshimet në emërtime në disa pozicione tjera, për të cilat u vlerësuan të arsyeshme dhe domosdoshme për ndryshim.

Përderisa në nenin 24 është zvogëluar numri i punë-kryesve nga tre në dy, në neni 14 dhe 86 pas analizës së punëve dhe ngarkesës që këta zyrtarë kanë në terren i janë shtuar pozicionit edhe nga një punë-kryes, respektivisht nga një (1) sa kanë qenë për secilën pozitë janë bërë me nga dy (2) punë-kryes.

Ndryshimet në nenin 19 dhe 21, duke marrë parasysh shkallshmërinë e punëve brenda departamentit dhe sektorit është vlerësuar se niveli i kërkuar i përgatitjes profesionale për këto pozita ka qenë me mbikualifikim. Llojet e certifikimeve të kërkuara për këto pozita kanë qenë të njëjta si për zyrtarët ashtu edhe nivelin e pozitës më të lartë në hierarki, atë të menaxherit, të cilat mund të reflektonin në nivelet e ngritjes se koeficientit në pagë apo edhe ngritjeje në detyrë pa pasur mundësi pozitë e hierarki të kësaj natyre. Ndërsa, në nenin 28 është krijuar mundësia që në bazë të kualifikimeve të kenë mundësi pune edhe personat me shkollim të mesëm meqë nuk kërkohet aftësi e lartë për një punë zyrtari me kompetenca kryesisht teknike të kryerjes së detyrës dhe në nenin 26 janë zgjeruar mundësitë edhe me kualifikime nga fusha tjera të përshtatshme të studimeve për këtë pozitë.

Ndryshimet tjera, në bazë të këtij vendimi, përfshijnë aspektet teknike apo gabimeve që kanë rrjedhur në riemërtimin e disa pozitave të vendeve të punës, të cilat janë harmonizuar me emërtimet edhe në dokumente apo rregullore tjera të Ndërmarrjes.

Të bashkëngjitur me këtë vendim janë këto dokumente:

- Raporti i Komisionit për plotësim-ndryshime të Rregullores mbi Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës nr. I/130 datë 29.08.2024;
- Opinioni i Zyrës Ligjore të Ndërmarrjes;
- Kërkesa e Menaxhmentit për plotësim-ndryshime.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues



Iu dërgohet:

- Menaxhmentit të HK-Trainkos Sh.A
- Aksionarit – NJPMNP
- Arkivit